



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Komuna Vushtrri
Opstina Vucitrn – Municipality of Vushtrri



Komisioni Komunal për dhënien në shfrytëzim

të pronës së paluajtshme Komunale

Nr.05/2017

Dt.16.5.2017

Në bazë të nenit 5 dhe 8 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 4, 7 dhe 8 të Rregullores QRK NR.23/2013 Për përcaktimin e procedurave të dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, nr.01Nr.50/17 të dt.23.02.2017, Komuna e Vushtrrisë shpallë këtë:

NJOFTIM PËR ANKAND PUBLIK
PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONËS SË PALUJTSHME KOMUNALE

NENI 1: EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri i AK Komuna Vushtrri Komisioni Komunal për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale	Personi kontakt: Bedri Dobra tel.044/212-646 Ilirjana Azemi tel.044/347-419
Adresa SHESHI ‘‘HASAN PRISHTINA’’	Kodi postar 42000
QYTETI Vushtrri	Komuna Vushtrri
E-mail pronatkomunale@gmail.com	

NENI 2: LËNDA E ANKANDIT

Komuna e Vushtrrisë-**Komisioni Komunal për dhënie në shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme Komunale**, në bazë të Vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, nr.01Nr.50/17 të dt.23.02.2017, ka përcaktuar dhënien në shfrytëzim afatshkurtër me kompensim të pronës së paluajtshme komunale përmes ankandit publik procedurës së ofertave të mbyllura.

Dhënia në shfrytëzim afatshkurtër e pronës së paluajtshme komunale, si në vijim:

*Ngastra kadastrale P-70202022-00209-0 me kulturë arë e kl.e 5 (pest), me sipërfaqe prej 23.45.12 ha, Zona Kadastrale Gracë , pronë e komunës së Vushtrrisë.

*Ngastra kadastrale P-70202022-00492-0 me kulturë arë e kl.e 4 (katërt), me sipërfaqe prej 11.97.88 ha, Zona Kadastrale Balincë , pronë e komunës së Vushtrrisë.

3. Të drejt pjesëmarrjes kanë personat fizik dhe personat juridik;
4. Kriteri i dhënies së kontratës :Oferta e përgjithshme me çmimin më të lart;
5. Çmimi fillestar për një 1 ha në vit është 50.00€.
6. Afati i dhënies në shfrytëzim të pronës është 15 vite.
7. Veprimtaria që ushtrohet në tokat e dhëna në shfrytëzim është veprimtari bujqësore, kryesisht për kultura lavërtari.

NENI 3: AFATET DHE PROCEDURAT

1. Ankandi Publik është i hapur 30 ditë nga dita e shpalljes së Ankandit;
2. Afati kohorë i fundit për tërheqjen e dokumentacionit të ankandit është data: 13.06.2017 ora 15:00
3. Afati kohorë për dorëzim-pranimin e aplikacioneve është data: 15.06.2017 , më së largu deri në ora 14:00 vendi Komuna e Vushtrrisë ,zyra e pranim-it-arkiva,zyra nr.1 kati përdhese.
4. Ofertata duhet dorëzuar të mbyllura; tërheqja e aplikacioneve mund të bëhet në formë fizike dhe elektronike nëpërmes E-mail:pronatkomunale@gmail.com.
5. Takimi për hapjen e aplikacioneve bëhet me datën:15.06.2017 , vendi Salla e Kuvendit Komunal – Vushtrri.
6. Informacionet shtesë mund ti kërkoni te z.Bedri Dobra ,Drejtoria e Kadastrit Gjeodezisë dhe Pronës dhe znj.Ilirjana Azemi ,Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

NENI 4:ANKESAT

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë te Komisioni për Ankesa pran Komunës së Vushtrrisë, sipas dispozitave të nenit 9 pika 3 të Ligjit Nr. 04/L-144, Ligji për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme Komunale.